

Epoka e errët e Periudhës Komuniste në Baldushk-Tiranë, një qasje analitike mbi Kulakët dhe krijimin e Tuneleve.

ERTA BETI

MA.Arkivistikë Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë - Universiteti i Tiranës

Specialiste Arkivi. Ka përfunduar studimet e larta në 2024, FHF-UT, Departamenti i Historisë, Master Profesional Arkivistikë dhe aktualisht është punësuar si specialiste arkivi në profesion. Përgjatë rrugëtimit studentor, ka marrë pjesë në praktika pune të zhvilluara në kuadër të programit të ekselencës nga Departamenti i Administratës Publike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Gjithashtu është angazhuar në konferenca dhe seminare të ndryshme akademike dhe profesionale, mbi studimin e arkivave si dhe disa publikime mbi historinë, arkivat dhe sfidat në kuadër të integritetit evropian.

Renata Beti

Msc. Marrëdhënie Ndërkombëtare Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë-Universiteti i Tiranës

Ka përfunduar studimet e larta në 2024, FHF-UT, Departamenti i Historisë, Mastër Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe aktualisht po ndjek një praktikë pune në Ministrinë e Jashtme. Përgjatë rrugëtimit studentor, ka marrë pjesë në trajnime të organizuara nga Instituti i Studimeve Evropiane ndër to mund të përmendim: “History of European Integration” in the framework of the Jean Monnet Chair project “OwnEU” dhe “EU Enlargement and the Western Balkans” in the framework of the Jean Monnet Chair project OwnEU, implemented by the Institute of European Studies, “EU Institutions and Policy Making” in the framework of the Jean Monnet Chair project OwnEU, implemented by the Institute of European Studies. Së fundmi kam marrë pjesë në Konferencën shkencore “Dritëhije” organizuar nga Muzeu Shtëpia me Gjethe me kumtesën e paraqitur “Lindja e Muzeve gjatë periudhës komuniste si vende në kujtesë”.

ABSTRAKT

Një nga ngjarjet më të mprehta të shoqërisë shqiptare, e cila duket sikur zbehet dhe rikthehet sërish në qendër të vëmendjes, është ai që lidhet me të shkuarën, me të shkuarën e viteve të komunizmit. Bëhej fjalë gjatë viteve 1944-1991, një nga periudhat më të errëta të historisë së Shqipërisë. Me vendosjen e diktaturës komuniste. Baldushku ka një histori interesante gjatë periudhës së komunizmit, kooperativa bujqesore ishte një nga strukturat kryesore ekonomike në atë zonë.

Rrëfimet janë të trishta nga ish të burgosurit politik në një zonë të Tiranës në Baldushk, duke përbërë kështu një reflektim dhe një memorie kolektive të historisë së Shqipërisë gjatë periudhës komuniste, një shikim prapa për të parë se si ka qenë e shkuara në vendin tonë dhe çfarë nuk duhet të përsërisim në të ardhmen.

Misteri shoqëron çdo pjesë të historisë së Shqipërisë gjatë viteve të diktaturës, lufta kundër kulakëve dhe të persekutuarëve në përgjithësi, përbënin thelbin e konfliktit brenda shoqërisë shqiptare edhe pas njëzet vjet nga rënia e regjimit komunist. Megjithëse për gjysmë shekulli me radhë, shteti dhe regjimi komunist u grabiti kulakëve pasurinë, të drejtat dhe lirinë, madje pjesës më të madhe të tyre edhe Historinë. Mohimi i të drejtave themelore të njeriut, frika që ngjallte regjimi komunist ndaj jetës së njerëzve i bindi ata të kërkonin zgjidhje të reja. Komunistët erdhën në pushtet nëpërmjet luftës së krijuar kundër kundërshtarëve politike duke e mbajtur pushtetin me anë të dhunës, si tipari kryesor i luftës së klasave, individeve dhe grupeve të shumta brenda gjirit të partisë së krijuar.

Ndërkohë u dëbuan nga qytetet kryesore dhe zonat kufitare me dhjetëra e mijëra banorë, të cilët konsideroheshin si kundërshtarë apo të rrezikshëm për regjimin, ndërsa u ekzekutuan edhe ata persona që tentonin të kalonin ilegalisht kufirin për tu arratisur nga vendi. Shpronësime, shtetëzime, tatime të jashtëzakonshme, shpifje, demaskime, izolime, burgosje, ekzekutime, ishin mjete për likuidimin ekonomik, izolimin politik dhe eliminimin fizik, ndërsa ata që do të mbijetonin, të mos mund të kishin influencë në popull dhe të denigroheshin. Termi kulak gjatë periudhës komuniste, përdorej për të stigmatizuar familjet që konsideroheshin “më të pasura” apo “kundërshtarë të vijës së partisë”, shpesh pa asnjë bazë reale. Trajtimi ndaj tyre ishte i ashpër: u nënshkroheshin tatimeve të tepërta, internimeve, punëve të detyruara dhe përjashtimit nga jeta shoqërore. Një rrjet tunelesh të krijuara gjatë periudhës komuniste në çdo lagje duke i pasur kështu për rastet e luftës, të ndërtruara gjatë regjimit komunist në raste të sulmeve nga ish-Jugosllavia, kjo zonë përdori tunelet për të krijuar një të ardhme më të sigurtë.

Fjalë Kyçe: Periudha Komuniste, Baldushk, Histori Persekutimi, Dëshmi, Kulakë, Kujtesa Historike.

ERTA BETI

MA. Archivist Faculty of History and Philology - University of Tirana

RENATA BETI

Msc. International Relations Faculty of History and Philology - University of Tirana

The Dark Ages of the Communist Period in Baldushk-Tirana, an analytical approach to the Kulaks and the creation of the Tunnels.

ABSTRACT

One of the most poignant events in Albanian society, which seems to fade and then return to the center of attention, is the one related to the past, the past of the communist years. It was during the years 1944-1991, one of the darkest periods in the history of Albania. With the establishment of the communist dictatorship. Baldushku has an interesting history during the communist period, the agricultural cooperative was one of the main economic structures in that area. The stories are sad from former political prisoners in an area of Tirana, thus constituting a reflection and a collective memory of the history of Albania during the communist period, a look back to see how the past was in our country and what we should not repeat in the future. Mystery accompanies every part of the history of Albania during the years of dictatorship, the fight against the kulaks and the persecuted in general, constituted the essence of the conflict within Albanian society even after twenty years from the fall of the communist regime. Although for half a century, the state and the communist regime robbed the kulaks of their wealth, rights and freedom, and even their History for most of them. The denial of basic human rights, the fear that the communist regime aroused towards people's lives convinced them to seek new solutions. The communists came to power through the created war against political opponents, maintaining power through violence, as the main feature of the struggle of classes, individuals and numerous groups within the bosom of the created party. Meanwhile, tens of thousands of residents were expelled from the main cities and border areas, who were considered opponents or dangerous to the regime, while those who attempted to illegally cross the border to flee the country were also executed. Expropriations, nationalizations, extraordinary taxes, slander, unmasking, isolation, imprisonment, executions, were means of economic liquidation, political isolation and physical elimination, while those who would survive, could not have influence on the people and were denigrated. The term kulak during

the communist period was used to stigmatize families that were considered “the richest” or “opponents of the party line”, often without any real basis. Their treatment was harsh: they were subjected to excessive taxes, deportations, forced labor, and exclusion from social life. A network of tunnels created during the communist period in every neighborhood, thus having them in case of war, built during the communist regime in case of attacks from the former Yugoslavia, this area used the tunnels to create a safer future.

Keywords: Communist Period, History of Persecution, Testimony, Kulaks, Historical Memory.